



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1723 / Prot
17

Tiranë, më 17 / 11 / 2021

VENDIM

Nr. 50 , datë 17 . 11 . 2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) Formularin e Ankesës nr. 1723 Prot., datë 15.10.2021, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Banka e Shqipërisë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit nëpërmjet e-mail-it datë 15.09.2021, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

- *Emrat dhe pozicionin përkatës të të gjithë punonjësve aktualë pranë Bankës së Shqipërisë, përfshirë pagën mujore.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, (në vijim LDI).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 1723/1 prot., datë 19.10.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit, brenda datës 26.10.2021.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 4612/1 Prot., datë 26.10.2021, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1723/2 Prot., datë 28.10.2021, ka sqaruar ndër të tjera se: *“...Banka e Shqipërisë administron të dhënat personale të punonjësve të tij, në bazë të dispozitave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (ligji për mbrojtjen e të dhënave personale) si dhe dispozitave të rregullores “Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 21, datë 16.05.2007, e ndryshuar, (rregullorja). Këto të dhëna personale përfshijnë informacione të karakterit profesional e administrativ, si dhe informacione të tjera personale për çdo punonjës të institucionit. Çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar apo të identifikueshëm, përbën të dhënë personale në kuptimin që jep neni 3 i ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Në rastin konkret duke qenë se të dhënat që kërkohen identifikojnë personin fizik (punonjësin) të cilit i përkasin, ato kategorizohen si e dhënë personale e tij në kuptim të nenit 3 të ligjit, dhe për rrjedhojë bazuar në nenin 27 dhe 28 të këtij ligji përdoren vetëm për qëllimin përse janë mbledhur dhe konsiderohen konfidenciale, pra jo publike. Këtë logjikë ka parasysh edhe neni 7 i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili në shkronjën “d” të tij konsiderohen ndër të tjera si të dhëna publike pagat vetëm të funksionarëve të cilët kanë detyrim deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, ndërsa për nëpunësit e tjerë ky ligj nuk kërkon identifikimin me të dhëna personale. Për rrjedhojë, në zbatim të dispozitave të sipërcituara Banka e Shqipërisë nuk mund të vendosë në dispozicion të dhëna që identifikojnë punonjësit...”*

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga ana e Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, me Urdhrin nr. 162, datë 03.11.2021, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke filluar nga data 04.11.2021.

Pas dërgimit të urdhrin të sipërcituar dhe regjistrimit pranë Autoritetit Publik me nr.4872 Prot., datë 03.11.2021, nga ana e koordinatorës për të drejtën e informimit pranë këtij autoriteti, u kërkuua shtyrja e zhvillimit të inspektimit administrativ, për shkak të angazhimit të stafit për përgatitjen e paraqitjes së Guvernatorit në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave. Kërkesë kjo e cila u miratua nga Zyra e Komisionerit. Për shkak të kërkesës së Autoritetit Publik, Komisioneri, bazuar në nenet 53, 91 dhe 92 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 1723/5 Prot., datë 05.11.2021 “Për zgjatjen e afatit të

procedurës administrative”, vendosi shtryrjen e afatit të përfundimit të procedurës deri me datë 26.11.2021.

Grupi i inspektimit u paraqit pranë Autoritetit Publik dhe kontaktoi me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, e cila sqaroi se:

“Kërkesa për informacion e z. datë 15.09.2021 është depozituar me anë të e-mail-it datë 15.09.2021 dhe më pas është përcjellë për trajtim me e-mail-in datë 16.09.2021 Shefit të Kabinetit, si dhe për dijeni, Drejtorit të Burimeve Njerëzore, Përgjegjësit të Sektorit të Marrëdhënies së Punësimit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Përgjegjëses të Sektorit në Kabinetin e Autoritetit Publik dhe Përgjegjëses së Zyrës së Shtypit.

Në vijim, grupi i inspektimit kërkoi të kontaktojë me personat përgjegjës të cilëve i ka kaluar për trajtim kjo kërkesë, për të administruar qëndrimin përfundimtar në lidhje me çështjen objekt inspektimi.

Përfaqësuesi i Departamentit të Burimeve Njerëzore, departament të cilit i është përcjellë kërkesa sqaroi se: *“Për shkak të mungesës së theksuar të stafit për arsye shëndetësore dhe kufizimeve në mjediset e punës për shkak të pandemisë nuk u bë e mundur që praktika të trajtohej në kohë. Praktika ishte perfshirë në listën e praktikave për trajtim por fluksi i punës dhe mungesa e theksuar e stafit në këtë periudhë e beri të pamundur trajtimin e praktikës në kohë”.*

Në përfundim të inspektimit, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, nisur nga informacioni që kërkohet, kjo çështje duhet të trajtohet me LDI, por edhe me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).

Në qëndrimin e Autoritetit Publik konstatohet se, kufizimi i aksesit është bërë në referim të nenit 3, 27 dhe 28 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe rregullores “Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 21, datë 16.05.2007, pa marrë parasysh dispozitat përjashtuese të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në parim, e drejta e aksesit në të dhënat personale sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është një e drejtë që gëzohet nga subjekti i të dhënave personale. Në rastin konkret, kërkesa për informacion e paraqitur nga ankuesi bazohet në LDI dhe në nenin 17 të tij jepen rastet e kufizimit të dhënies së informacionit, ku një nga kufizimet është edhe ruajtja e jetës private. Por, duke qenë se kërkohen të dhëna që lidhen me ushtrimin e detyrës funksionale të punonjësve në një autoritet publik sipas ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, gjen zbatim shkronja b) e pikës 4 të nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin parashikohet se “Ky ligj

nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre”.

Ky parashikim aplikohet sipas legjislacionit në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë të të dhënave. Në këtë kuptim, përhapja e informacionit duhet të kufizohet vetëm me aksesimin e dokumenteve të dosjes personale të subjektit të të dhënave (*kopje e diplomës, etj*), që përmbajnë të dhëna personale të lidhura ngushtësisht me individin dhe, si të tilla, nuk mund të vihen në dispozicion të askujt pa pëlqimin paraprak të tij.

Ndërkohë nga verifikimi i kërkesës rezulton se ajo konsiston në marrjen e informacionit mbi emrat, pozicionin përkatës të të gjithë punonjësve aktualë pranë Bankës së Shqipërisë, përfshirë pagën mujore dhe jo aksesimin e dokumentacionit që përmban të dhëna personale, për të cilat mund të zbatohen dispozitat e cituara nga Autoriteti Publik.

Gjithashtu, bazuar në nenin 7, pika 1, shkronja d të LDI dhe Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar, të Komisionerit, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Konkretisht, dispozita e sipërcituar përcakton se: *“Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime”.*

Për sa më sipër, Autoriteti Publik në përputhje me dispozitën e sipërcituar duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, në kushtet kur një pjesë e informacionit të kërkuar rezulton publik në mënyrë proaktive në programin e tij institucional të transparencës.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.* Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Në këtë kontekst në lidhje me të njëjtën kërkesë për informacion, Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1723 Prot., datë 15.10.2021, të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Banka e Shqipërisë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 15.09.2021, konkretisht: “Emrat dhe pozicionin përkatës të të gjithë punonjësve aktualë pranë Bankës së Shqipërisë, përfshirë pagën mujore”, brenda datës 24 . 11 .2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 17 . 11 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

